



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi		Datë: 14.12.2018	Numri i seancës për këtë çështje: 1
<p><i>Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut" – projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH).</i></p>			
A. Informacioni bazë			
Institucioni dhe tema:	<i>Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, seanca dëgjimore e subjektit të rivlerësimit</i>		
Emri i subjektit të rivlerësimit	<i>Alma Kolgjoka</i>		
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	<i>Kryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë</i>		
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	<i>Seanca u shty për dhënien e vendimit për në datë 17 Dhjetor, ora 09:15, dhe trupi gjyqësor nuk paraqiti asnjë arsye për këtë shtyrje.</i>		
paraqisni arsyet në mënyrë të përmbledhur)	<i>Vendimi nuk u shpall në përfundim të seancës dëgjimore, në kundërshtim me nenin 55 pika 6 të ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve".</i>		
B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca			
Trupa gjyqësore (emrat)	Suela Zhegu, kryesuese, Brunilda Bektashi, relatore dhe Valbona Sanxhaktari, anëtare.		
Monitoruesit ndërkombëtarë (emrat)	Z. Theo Jacobs		
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	Personalisht		
Monitoruesi/ja i/e KSHH:	<i>Migena Kondo</i>		
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	10 anëtarë nga publiku. Seanca u monitorua edhe nga një vëzhgues i Avokatit të Popullit.		
Media e pranishme:	Në sallën ku u zhvillua seanca dëgjimore u vu re një numër i vogël i përfaqësuesve të medias. Kështu, seanca u monitorua nga përfaqësues të medias së shkruar, (BIRN, dhe Gazeta Shekulli) dhe nuk u vërejt asnjë operator i medias që të kryente video regjistrimin e çeljes së seancës dëgjimore.		
C. A vendosi institucioni i vettingut ta bëjë vettingun për të tre kriteret apo bazuar vetëm në një apo dy prej tyre?	<i>Po</i>	<i>Nëse po, si u justifikua ai?</i>	<i>Nëse po, si ka reaguar subjekti ndaj kësaj ?</i>
	Rivlerësimi i këtij subjekti u krye në bazë të të tri kriterëve: pasuria, figura dhe aftësitë profesionale.	Të tre kriteret u vlerësuar pozitivisht për këtë subjekt	Subjekti ishte dakord me përfundimet e hetimit të KPK

D. Përmbajtja e çështjes (Vlerësimi i kritereve)	Argumenti	kush e ka dhënë argumentin	A u diskutua? Prova? A u kalua barra e provës ?
D1. Pasuria	Në lidhje me këtë kriter, relatorja e çështjes paraqiti rezultatet e vlerësimit të institucionit ndihmës, ILDKPKI, i cili kishte konstatuar pozitivisht lidhur me deklarin dhe ligjshmërinë e të ardhurave që justifikojnë pasuritë e subjektit , si dhe mungesën e situatës së konfliktit të interesit.	ILDKPKI	Nga seanca nuk doli e qartë nëse subjekti ka paraqitur argumente dhe fakte e prova gjatë procesit të hetimit të KPK, dhe nëse u kalua barra e provës.
	Në përfundim të hetimit të saj KPK ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit disponon pasuritë si më poshtë: <u>1. Auto veturë në vlerën e 3999 eurove.</u> Nga verifikimet e kryera Komisioni ka konkluduar se çifti Kolgjokaka pasur burime të ligjshme dhe të mjaftueshme për blerjen e kësaj makine. <u>2. Shtëpi private në proces legalizimi.</u> E ndërtuar nga vjehri i saj përpara martesës së gjyqtarës Kolgjoka. <u>3. 200 mijë lekë kesh në shtëpi.</u> Për këtë shumë parash KPK ka konkluduar se bashkëshortët Kolgjoka kanë pasur burime të mjaftueshme dhe të ligjshme për t'i grumbulluar. <u>4. Depozitë 2 milionë e 100 mijë lekë.</u> KPK ka vërejtur se subjekti i ka deklaruar këto para në deklaratat periodike ndër vite dhe se ka pasur burime të ligjshme e të mjaftueshme për krijimin e kësaj shume. Si përfundim, KPK konkludoi pozitivisht , se lidhur me pasuritë e verifikuara të subjektit është vërtetuar nga hetimi i KPK se ajo ka pasur mundësi t'i krijojë shumat e verifikuara dhe të përballojë shpenzimet e deklaruara me burime të ligjshme. Vërehet se KPK nuk përmendi ndonjë tablo të analizës financiare me bilancet përkatëse vit pas viti për këtë subjekt.	Relatori	
	n/a	Mbrojtja	
	Subjekti u shpreh dakord me konstatimet e relatorit	Subjekti	
	asnjë	Ankesa nga publiku	
	asnjë	ONM	
	D2. Figura /Kontaktet me krimin e organizuar	Relatorja e çështjes u shpreh se për këtë kriter organi ndihmës, DSIK në raportin e tij kishte konkluduar pozitivisht për përshtatshmërinë e figurës së këtij subjekti të rivlerësimit për të vazhduar detyrën sipas ligjit.	
Relatorja Bekteshi u shpreh pozitivisht lidhur me këtë kriter por nuk doli e qartë nëse KPK ishte bazuar edhe në të dhëna të tjera përveç raportit të DSIK për hetimin e saj lidhur me këtë kriter.		Relatori	
n/a		Mbrojtja	
Subjekti u shpreh dakord me konstatimet e relatorit		Subjekti	
asnjë		Ankesa nga publiku	
asnjë		ONM	

D3. Vlerësimi i aftësive profesionale dhe etikës	Relatorja e çështjesh u shpreh se Inspektorati i KLD ka paraqitur një raport të detajuar të hartuar ne bazë të burimeve dhe kriterëve të vlerësimit profesional sipas ligjit. KPK nuk u shpreh lidhur me përbajtjen e këtij raporti të Inspektoratit të KLD.	Raporti i hollësishtëm i Inspektoratit të KLD.	JO, pasi subjekti nuk u gjet ne situatë të shkeljes disiplinore, për shkak të kriterit të aftësive profesionale
	KPK, në bazë të raportit të Inspektoratit të KLD dhe të dhënave të tjera të marra gjatë hetimit, përfshirë ato nga arkiva e KLD, ka konkluduar pozitivisht lidhur me këtë kriter, duke u shprehur se janë respektuar të drejtat e palëve dhe vetëm <u>në një rast</u> , në një vendim të vitit 2013, është konstatuar se ishin tejkaluar afatet e gjykimit, dhe palët kishin bërë kërkesë për prova të reja. KPK u shpreh edhe se gjyqtarës ishin paraqitur pesë denoncime nga publiku.	Relatori	
	Subjekti u shpreh dakord me konstatimet e relatorit.	Subjekti, etj..	
	Vëzhguesi ONM, Theo Jacobs, e pyeti subjektin e rivlerësimit se si i vlerësonte ajo aftësitë e saj menaxhuese, në cilësinë e kryetares së gjykatës, në lidhje me adresimin e çështjes së vonesave në gjykim dhe numrin e lartë të seancave për një çështje. Ai i sugjeroi subjektit të rivlerësimit që të ishte e kujdesshme me përdorimin e burimeve në gjykata për të rritur efektivitetin dhe eficientë të punës. Gjyqtarja Kolgjoka u shpreh se ajo do të vazhdojë përpjekjet e saj për të ndrequr këtë problematikë.	OMN	
E. Konkluzione dhe komente të monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e procesit të drejtë ligjor (publiciteti, etika e organeve të vettingut dhe përfaqësuesit të OMN, si e vlerësoni hetimin administrativ, të drejtat e mbrojtjes së subjektit, barazia e mjeteve ligjore, parimi i kontradiktoritetit, koha e arsyeshme, e drejta për të paraqitur prova dhe e drejta për tu dëgjuar, etj.)	<p>Parimi i publicitetit të gjykimit Data, vendi, dhe ora i zhvillimit të seancës dëgjimore u njoftua publikisht në faqen zyrtare të internetit të KPK. Në drejtim të respektimit të parimit të publicitetit të seancës vërehet një zhvillim pozitiv pasi seanca u zhvillua në sallën e Pallatit të Koncerteve, e cila ofron një kubaturë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për pjesëmarrjen e publikut që dëshiron të ndjekë seancat. Gjatë seancës dëgjimore</p> <p>relatorja e çështjes përmendi se para Komisionit ishin paraqitur 5 denoncime nga publiku, por nga relatimi i saj mbeti në mjegull se çfarë përmbanin këto denoncime, dhe arsytet e mos marrjes parasysh nga ky Komision. Kjo çënon parimin publicitetit të seancës, ku duhet të diskutohet në mënyrë të plotë të gjitha rrethanat dhe argumentet lidhur me çështjen për t'i dhënë mundësi publikut të vlerësojë mënyrën se si KPK e administron procesin në fjalë. Aksesi në mjediset e zhvillimit të seancës dëgjimore</p> <p>Lidhur me aksesin fizik në sallën ku zhvillohej seanca dëgjimore, vërehet mungesë e shenjzimit të dukshëm dhe të përshtatshëm për orientimin e publikut dhe medias. Pas disa vështirësive për të aksesuar sallën, vëzhguesi u pyet se kë përfaqësonte dhe të nënshkruante një listë-prezencë në hyrjen e saj. Lidhur me</p> <p>kompetencat e vëzhguesit të ONM Gjatë seancës dëgjimore, vëzhguesi i ONM, i dha subjektit të rivlerësimit disa këshilla në lidhje me menaxhimin efikas të burimeve në gjykata, në të ardhmen, për të shmangur vonesat në gjykim. Në bazë të nenit B, pika 3, shkronja "b" të Aneksit të Kushtetutës "...vëzhguesi ndërkombëtar paraqet gjetje dhe mendime, mbi çështje që shqyrtohen nga Komisioni dhe nga Kolegji i Apelit, si dhe kontribuon për kontrollin e figurës sipas nenit DH." Gjithashtu, neni 55 pika 3 e Ligjor 84/2016, parashikon të drejtën e vëzhguesit ndërkombëtar për t'i drejtuar pyetje subjektit gjatë seancës dëgjimore. Nënvizojmë se roli dhe detyrat që Kushtetuta dhe ligji u kanë dhënë vëzhguesve ndërkombëtarë janë të kufizuara vetëm në lidhje me procesin e rivlerësimit dhe mbarëvajtjen e tij, dhe jo me aspekte të tjera të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, siç është menaxhimi i burimeve njerëzore në të ardhmen, që janë kompetencë e organeve të reja qeverisëse të gjyqësorit, në rastin konkret KLGJ. Konkludojmë se vëzhguesi ndërkombëtar ka tejkaluar fushën e kompetencave të tij në këtë rast.</p>		